



RAPORT VJETOR

Drejtoria: *Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit*

Për. raport.: *Janar – dhjetor 2019*

- **Përmbledhje e Drejtorisë** – ndarja në sektorë, numri i punonjësve dhe funksionet kryesore të Drejtorisë:

Sektorë në kuadër të Drejtorisë:

1. Sektori për shërbime publike;
2. Sektori për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit;
3. Sektori për siguri dhe emergjenca;
4. Sektori i transportit dhe trafikut.

Punonjësit në kuadër të sektorëve:

1. Sektori për shërbime publike ka 8 punonjës;
2. Sektori për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit ka 4 punonjës;
3. Sektori për siguri dhe emergjenca ka 10 punonjës;
4. Sektori i transportit dhe trafikut ka 3 punonjës;

Funksionet kryesore të Drejtorisë (sektorëve)

Funksionet e Sektorit për shërbime publike:

- Jep pëlqim për shfrytëzimin e hapësirave publike në përputhje me planet dhe rregulloret komunale;
- Në bazë të ligjit dhe udhëzimeve administrative, bënë trajtimin e qenve endacakë.
- Në bashkëpunim me banorët, bënë rregullimin dhe riparimin e ashensorëve në banesat kolektive;
- Bënë planifikimin dhe menaxhimin e mirëmbajtjes, rikonstruktimit, zgjerimit dhe modernizimit të rrjetit të ndriçimit publik;
- Bënë vendosjen e pompave shtytëse në objektet e larta kolektive dhe lokacione me presion të ulët të furnizimit me ujë;
- Bënë rregullimin dhe inventarizimin e hapësirave publike;
- Bënë rregullimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve, fontanave dhe krojeve publike;
- Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë-veprimtarisë së Drejtorisë.

Funksionet e Sektorit për menaxhimin e mbeturinave dhe mjedisit:

- Mbikëqyrë mbledhjen, transportimin deri në deponi të mbeturinave nga amvisëritë, institucionet dhe lokalet afariste, mbeturinave të vëllimshme, mbeturinave ndërtimore, mbeturinave të biodegradueshme dhe kompostimin e tyre, si dhe llojeve tjera të mbeturinave të cilat janë në kompetencë të nivelit lokal;
- Monitoron rrjedhjen e ujësllësit, të kanalizimit dhe përpunimin e ujërave të zeza, në bashkëpunim me KUR "Prishtina";
- Organizon dhe mbikëqyrë mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve dhe trotuareve në zonën urbane dhe rurale të komunës;
- Bën mirëmbajtjen dhe zhbllokimin e rrjetit të kanalizimit atmosferik;
- Angazhohet për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmtimit të mjedisit përmes eliminimit të deponive ilegale;
- Përcakton lokacionin e kontejnerëve;
- Informon publikun për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Në përputhje me ligjet dhe aktet komunale, përgatit programin për uljen e nivelit të ndotjes së mjedisit dhe propozon projekte për mbrojtjen e mjedisit, në bashkëpunim me institucione qendrore e lokale dhe donatorë;
- Mbikëqyrë administrimin e vlerave natyrore, si: ajri, uji, toka, pyjet, lëndët minerale dhe të mirat natyrore publike;
- Propozon masat për monitorimin e cilësisë, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujit, ajrit, tokës dhe natyrën e zonës së komunës, dhe siguron zbatimin e tyre;
- Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.

Funksionet e Sektorit për emergjenca:

- Vlerëson rrezikshmërinë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera brenda territorit të komunës, si dhe harton planet për mbrojtje;
- Kujdeset për funksionimin e sistemin të alarmit në rast të rrezikut;
- Kujdeset për furnizimin me ujë të pijshëm me cisterna dhe rezervuarë të veçantë, në raste emergjente;
- Bën pranimin e informatave nga qytetarët – subjektet komunale, institucione publike dhe jo publike, destinimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen, Qendra 0800 122 33, 0800 122 44, në shërbim 24 orë në 7ditë të javës;
- Në përputhje me ligjet dhe në rast nevojë, është përgjegjëse për koordinimin e punëve me institucionet qendrore dhe komunat tjera në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit;
- Në rastet e jashtëzakonshme, i propozon Kryetarit të Komunës shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe masat që duhet të ndërmerren për përballimin e situatës;
- Në përputhje me ligjet dhe aktet komunale, harton Planin për mbrojtje nga zjarri, Planin operativ emergjent dhe Planin nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- Kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e strehimoreve publike;
- Ndërmerr masa për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- Bën regjistrimin e objekteve të vjetra me rrezikshmëri të lartë, objekteve tjera me rrezikshmëri të lartë dhe zonave me rrezikshmëri të lartë;
- Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë-veprimtarisë së Drejtorisë.

Funksionet e Sektorit për transport dhe trafik:

- Koordinon aktivitetin dhe jep pëlqimin për veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave, me kompanitë publike dhe private, shoqatat e taksistëve individualë dhe operatorëve juridikë, sipas rregulloreve;
- Cakton linjat dhe rendin e udhëtimit për transportin publik të udhëtarëve, sinjalizimin e vend ndaljeve për autobusë, pritoreve të udhëtarëve;
- Cakton lokacionet për parkimin e veturave auto-taksi;
- Menaxhon sektorin me “Merimangë”, sipas rregullores, dhe përgatit procedurat për ankand publik për automjetet e konfiskuara, që kalojnë afatin e paraparë me ligj;
- Bashkëpunon me policinë për rregullimin e komunikacionit dhe ngritjen e sigurisë në komunikacion, në veçanti afër shkollave dhe institucioneve parashkollore;
- Kujdeset për sinjalizimin vertikal dhe horizontal të rrugëve ekzistuese dhe rregullon komunikacionin në qytetin e Prishtinës;
- Ndërtimi i nyjave të reja të semaforëve në udhëkryqet e qytetit dhe mirëmbajtja e semaforëve ekzistues;
- Vendos për mbylljen e përkohshme të rrugëve, për shfrytëzimin e tyre në raste të veçanta (festa shtetërore, punë të veçanta në interes të shtetit dhe komunës dhe punë të ngjashme);
- Mbikëqyrë kushtet e sigurisë së jetës dhe shëndetit të njerëzve në vendndërtim dhe rreth tij, gjatë zhvillimit të punimeve.

- **Realizimi i punëve (aktiviteteve)** – përpunimi/kryerja e lëndeve, realizimi i takimeve me palë, realizimi i projekteve:

- **Lëndët e përpunuar gjatë vitit 2019**

Gjatë viti 2019 janë përpunuar gjithsej - 4934.

- **Lëndët e kryera gjatë vitit 2019**

Gjatë viti 2019 janë përpunuar gjithsej - 4902.

- **Takimet me palë gjatë vitit 2019**

Takimet me palë, të realizuara gjatë vitit 2019, gjithsej – 1532.

- **Projektet e realizuara gjatë vitit 2019**

- 1. Ndërtimi i nyjave të reja semaforike (tri nyja semaforike):**

- Rruga “Muharrem Fejza”,
- Rruga “Ahmet Krasniqi”,
- Rruga “Eqrem Çabej”.

Vlera e kontratës	149,576.00€
Shuma e situacioneve të paguara	149,576.00€
Kontrata	2019

- 2. Ndërtimi i mureve rezistuese ndaj rrëshqitjeve të dheut:**

- Rruga “Trepça”, lagjja “Taukbahçe”, gjatësia 60m, lartësia 1.50 – 5.30, sipërfaqja e murit 252.8 m².

Vlera e kontratës	50,000.00€
Shuma e situacioneve të paguara	24,875.06€
Kontrata	2019/2020

3. Shpimi i puseve dhe ndërtimi i sistemit të ujitjes për gjelbërim

- Janë hapur 24 puse; mirëmbajtja, pastrim i 19 puseve; 2 sisteme pikë-pikë të ujitjes në sheshin "Adem Jashari" dhe në oborrin e objektit të vjetër të komunës.

Vlera e kontratës	150,000.00€
Shuma e situacioneve të paguara	139,086.50€
Kontrata	2019/2020

4. Pastrimi i shtratit të lumenjve, portave hyrëse në kolektor, kanalit atmosferik dhe zëvendësimi i kapakëve të pusetave:

• Pastrimi i shtretërve të përroskave urbane	7350 m´ ,
• Pastrimi i përroskave rurale	11150 m´ ,
• Pastrimi i kanaleve të hapura	1850 m´ ,
• Pastrimi i portave hyrëse dhe lëshesave	43 copë
• Pastrimi i shtretërve të lumenjve	19352 m´
• Pastrim i kanalizimit atmosferik dhe të kombinuar	83,178 m´

Vlera e kontratës	95,183.40€,
Shuma e situacioneve të paguara	56,899.50€
Kontratë në realizim	2019/2020

5. Riparimi dhe rregullimi i ashensorëve:

- Ka filluar ndërtimi i 3 ashensorëve të ri dhe riparimi i 1 ashensori tjetër në banesat kolektive.

Vlera e kontratës	89,889.96€
Kontratë në realizim	2018/2019

6. Menaxhimi i mbeturinave me sistemin e ri, ku arkëtimi kryhet në Komunë, kurse punët operative i kryen KRM "Pastrimi", në tërë territorin e komunës:

- Është bërë mbledhja e mbeturinave, dezinfektimi dhe pastrimi i kontejnerëve në tërë territorin e komunës. Janë larguar **53827.38 m³** mbeturina të vëllimshme:

Mbeturina nga demolimi	53,827.35 m ³
Mbeturina të vëllimshme	5,829.00 m ³
Të hyrat nga shërbimi i mbeturinave	2,077,095.52€
Vlera e kontratës	2,722,500.00€
Shuma e situacioneve të paguara	2,689,123.14€
Kontrata e përfunduar	2019/2020

7. Trajtimi i qeneve endacakë:

Trajtimi, kastrimi dhe sterilizimi i qeneve endacakë	1680 qenë
Vlera e kontratës	130,000.00€
Shuma e paguar	122,240.00€
Kontratë e përfunduar	2018/2019

Është nënshkruar kontrata për ndërtimin e strehimores së kafshëve endacake (janar 2020)

Vlera e kontratës	150,000€
Shuma e paguar	
Kontratë në realizim	2019/2020

8. Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik:

Ndërrimi i dritave	1482 drita
Vendosja e shtyllave	176 shtylla
Gjatësia e përfaqësuar në km	37 km
Vlera e kontratës	300,000.00€
Shuma e situacioneve të paguara	237,279.95€
Kontratë në realizim	2019/2020

9. Riparimi, larja, pastrimi i fontanave, krojeve dhe monumenteve;

• Fontana	7 copë
• Monumente	9 copë
• Kroje publike	10 copë
Vlera e kontratës	75,000.00€
Shuma e situacioneve të paguara	57,776.65€
Kontratë në realizim	2017/2020

10. Rregullimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve është nënshkruar në fund të vitit:

Vlera e kontratës	200,000.00€
Kontratë e saponëshkruar	2019/2020

11. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, zhblllokimi i kanalizimit atmosferik;

- Mirëmbajtja e rrugëve, Loto (I,II,III,IV,V,VI), 932 rrugë.

Vlera e kontratave (kontratë kornizë 3-vjeçare)	1,534,697.60€.
Shuma e situacioneve të paguara	237,167.32€
Kontratë në realizim	2019/2022

12. Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve, zhblllokimi i kanalizimit atmosferik:

- Mirëmbajtja e rrugëve, Loto (I,II,III,IV,V,VI), 932 rrugë.

Vlera e kontratave (kontratë kornizë trivjeçare)	1,141,759.44€.
Shuma e situacioneve të paguara	380,586.48€
Kontratë në realizim	2019/2022

13. Furnizim i shtyllave antiparking dhe shtyllave lëvizëse me piston:

- Vendosja e shtyllave antiparking - 1246 copë;
- Vendosja e shtyllave U-profil - 140 -copë;
- Ngjyrosja e shtyllave antiparking - 1500 copë;
- Ngjyrosja e shtyllave U-profil - 1471 copë;
- Ngjyrosja e rrethojave metalike - 243 copë.

Vlera e kontratës	41,500.00€
Shuma e situacioneve të paguara	28,202.20€
Kontratë në realizim	2019/2022

14. Furnizim dhe instalim i nxehjes qendrore në objektin 2 të BPZ-së

Vlera e kontratës	16,359.67€
Shuma e situacioneve të paguara	13,564.55€
Kontratë e përfunduar	2019/2020

15. Furnizim me pompa shpine për shuarjen e zjarrit për BPZ.

- Furnizim me pompa shpine për shuarjen e zjarrit - 13 copë;

Vlera e kontratës	10,000.00€	
Shuma e situacioneve të paguara	9,724.00€	
Kontratë e përfunduar	2019	
16. Ndërtimi i impiantit të kompostimit:		
• Fillimi i punëve përgatitore për realizimin e projektit.		
Vlera e kontratës	139,782.20€	
Shuma e situacioneve të paguara	18,041.00€	
Kontratë në realizim	2019/2020	
17. Mirëmbajtja e semaforëve:		
Vlera e kontratës	149,960.00€	
Shuma e situacioneve të paguara	157,332.00€	
Kontratë në realizim	2017/2020	
18. Mirëmbajtja e ndriçimit publik:		
Vlera e kontratës	259,306.47€	
Shuma e situacioneve të paguara	152,762.13€	
Kontratë në realizim	2017/2020	
19. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve, Lloti I		
• Rrugët të përfunduara gjithsej	75	
• Vija dy komponentëshe	62000 m. gjatësi,	
• Vija një komponentëshe	40318 m. gjatësi	
• Vendkalime për këmbësorë (zebra)	9801 m ²	
• Vendkalim për këmbësorë me ngjyrë një komponentëshe	438.5 m ²	
Vlera e kontratës	188,375.00€	
Shuma e situacioneve të paguara	174,952.20€	
Kontratë në realizim	2018/2020	
20. Ndërtimi i qendrës për trajtimin e qenve endacakë në Hajvali:		
• Caktimi i lokacionit dhe projektimi i qendrës.		
Vlera e kontratës	150,000.00€	
Kontratë në realizim	2019/2020	
21. Ndërtimi i vendkalimeve për këmbësorë:		
• Caktimi i lokacioneve:		
Ngritja e vendkalimeve për këmbësorë	6 lokacione	Nga 25 lokacione
Panele ndriçuese	15 lokacione	22 panele
Shirita dridhës para rrethrotullimeve	14 rreth rrotullime	
Vlera e kontratës	134,100.00€	
Kontratë në realizim	2019/2020	
22. Hartimi i Planit operativ detaj për grumbullimin e mbeturinave në zonën “Qendër”, për të rritur nivelin e shërbimit. Ky plan është hartuar dhe implementuar në bashkëpunim me GIZ dhe KRM “Pastrimi”:		
• Evidentimi i nevojave dhe përcaktimi i lokacioneve më të ngarkuara;		
• Përcaktimi i makinerisë optimale për të ofruar shërbimin (inkorporimi i kamionetave për një efikasitet më të madh);		

- Përcaktimi i rrugëve optimale të operimit;
 - Përcaktimi i kohëve optimale të operimit me fokus uljen e pengesave në komunikacion dhe ngritjen e nivelit të shërbimit (ngritja e numrit të zbrazeve të kontejnerëve brenda 24 orëve mbi 5 herë min.);
 - Monitorimi i zbatimit të planit.
- 23. Themelimi i komisionit për vlerësimin teknik për rrezikshmëri të objekteve banuese dhe infrastrukture.**
- 24. Mbajtja e ushtrimit praktik “Simulim i tërmetit”, në bashkëpunim me AME, Policinë e Kosovës dhe Ndihmën e Mjekësisë Urgjente.**
- 25. Intervenime të rasteve emergjente dhe trajtimi i tyre nga inspektorët e SHP-së:**
- Gjithsej raste të trajtuara nga inspektorët e emergjencës - 237;
- 26. Pranimi i informatave – rasteve nga qytetarët dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen:**
- Gjithsej informata – raste të pranuar nga qytetarët dhe subjektet komunale - 5730;
- 27. Komisioni për trajtimin e hapësirave publike (tarracave):**
- Taksa për shfrytëzimin e hapësirave publike 306,069.27 €.
- 28. Monitorimi dhe inspektimi i strehimoreve.**
- 29. Përgatitja e Rregullores për menaxhimin e parkingjeve dhe çmimoreve përkatëse. Të dyja janë miratuar nga Kuvendi i Komunës.**
- 30. Përgatitja e projektregulloreve: Rregullorja për organizimin e transportit rrugor, Rregullorja për obligimet e pronarëve dhe bashkëpronarëve të pronës në Komunën e Prishtinës, Rregullorja për mbrojtjen e mjedisit.**
- 31. Përcaktimi i lokacioneve optimale për vendosje të kontejnerëve në zonën “Qendër”, lagjet “Tophane”, “Pejtoni”, “Lakërishta” dhe një pjese të Lagjes së Muhaxhirëve dhe “Aktashi”.**
- Evidentimi i nevojave dhe përcaktimi i lokacioneve më të ngarkuara;
 - Kontrollimi i sasisë së mbeturinave për pjesë të caktuara;
 - Evidentimi i lokacioneve tjera të nevojshme për eliminimin e ngarkesës në pika kritike;
 - Përcaktimi i numrit të kontejnerëve për çdo lokacion;
 - Hartimi i dizajnit final dhe përpunimi i përshkrimit teknik dhe paramasës.
- 32. Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës për Shërbimin e mbledhjes së mbeturinave, nga GIZ janë pranuar si donacion 190 kontejnerë 1.1m³. Nga ta ishin 120 kontejnerë nga plastika dhe 70 kontejnerë metalikë.**
- 33. Në bashkëpunim me BERZH dhe konsulentët britanikë, përpilimi i draft modelit për përfshirjen e operatorëve privatë të transportit publik dhe sistemit të integruar të transportit publik (biletë e integruar etj.).**
- 34. Si rrjedhojë e tërmetit në Shqipëri, kemi angazhuar tri ekipe emergjente për monitorimin e gjendjes në terren, ku njëherësh është bërë mobilizimi i kompanive të kontraktuara nga Komuna për intervenime në rast nevojë.**

Të hyrat nga: Tregu i automjeteve, lura në parkun “Gërmia”, taksa për shfrytëzimin e hapësirave publike, konfiskimi i veturave, parkingu te Pallati i Rinisë, të hyrat nga pagesa e mbeturinave:

	Te hyrat 2018	Te hyrat 2019
Të hyra nga pag. e mbeturinave	1,590,117.99€	2,077,095.52€
“Hortikultura”, “Gërmia”. “T. Aut.”	305,752.00€	308,051.00€
Konfiskim i automjeteve	31,221.86€	78,793.00€
Parkingu te “Pallati i Rinisë”	95,969.10€	87,953.45€
Taksë për shf. e hapësir. publike	448,425.31€	306,069.27€
Gjithsej	2,471,486.26€	2,857,962.24€

Krahasimi i të hyrave 2018-2019, kemi rritje prej 15.6%.

- **Planifikimi i punëve (aktiviteteve)** – punët ose aktivitetet të cilat do të fillojnë, janë duke vazhduar, dhe ato të cilat janë të planifikuara dhe ende nuk janë përfunduar.
 - **Aktivitetet (punët) që janë duke vazhduar nga viti 2019:**
 1. Ndërtimi i mureve rezistuese ndaj rrëshqitjeve të dheut;
 2. Pastrimi i shtratit të lumenjve, portave hyrëse në kolektor, kanalit atmosferik dhe zëvendësimi i kapakëve të pusetave;
 3. Mirëmbajtja e ndriçimit publik (2017-2020);
 4. Riparimi dhe rregullimi i ashensorëve;
 5. Menaxhimi i mbeturinave me sistemin e ri, ku arkëtimi kryhet në Komunë, kurse punët operative i kryen KRM “Pastrimi”;
 6. Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik 2019/2020;
 7. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, zhbllokimi i kanalizimit atmosferik;
 8. Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve, zhbllokimi i kanalizimit atmosferik;
 9. Riparimi, larja, pastrimi i fontanave, krojeve dhe monumenteve (2017-2020);
 10. Furnizim i shtyllave antiparking dhe shtyllave lëvizëse me piston;
 11. Vendkalimet e ngritura, panelet ndriçuese, shiritat dridhërues;
 12. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve rurale;
 13. Mirëmbajtja e Sistemit të alarmimit publik;
 14. Rregullimi dhe montimi i pompave për furnizim me ujë në ndërtesat kolektive;
 15. Rregullimi dhe rrethimi i varrezave të komunës së Prishtinës;
 16. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve;
 17. Vendosja rregullimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve 2019/2020;
 18. Ndërtimi i impiantit të kompostimit 2019/2020;
 19. Mobilieria urbane;
 20. Pritoret për autobusë;
 21. Mirëmbajtja e semaforëve (2017-2020);
 22. Mirëmbajtja e puseve dhe sistemit të ujitjes 2019/2020;
 23. Riorganizimi i lokacionit të kontejnerëve; rregullimi i vendit dhe furnizimi me kontejnerë 2019/2020;
 24. Pasurimi i databazës për konsumatorët e shërbimit të mbledhjes së mbeturinave përmes inkorporimit të regjistrimeve të reja në Protaks;
 25. Fillimi i zbatimit të modelit për përfshirjen e operatorëve privatë të transportit publik dhe sistemit të integruar të transportit publik (biletë e integruar etj.).

- **Aktivitetet (punët) që do të fillojnë në vitin 2020.**

1. Konsulencë për identifikimin e nevojave për komunikacion dhe trafik rrugor dhe trajtimin e hapësirave publike;
2. Inventarizimi i hapësirave publike;
3. Fushata vetëdijesuese (hedhja e mbeturinave, kyçja dhe shkyçja në rreth rrotullim, parkimi në hapësirat e caktuara për parkim, shfrytëzim eficient i energjisë etj.);
4. Riorganizimi i kontejnerëve, kontejner të rinj, rregullimi i platformave, furnizimi me komposter dhe shporta 2020/2021;
5. Intervenime, riparime dhe mirëmbajtja urgjente: intervenime me pompa shtytëse të ujit, puseta dhe ujëmbledhës, kanalizim atmosferik, fontana, kroje publike, monumente dhe mure rezistuese;
6. Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik 2020/2021;
7. Furnizim me makineri dhe pajisje;
8. Vendosja rregullimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve 2020/2021;
9. Mirëmbajtja verore e rrugëve rurale;
10. Hartimi i rregullores së brendshme të DSHPMSH-së;
11. Ushtrimi praktik “simulim i zjarrit”;
12. Mirëmbajtja e ndriçimit publik (2020-2023);
13. Mirëmbajtja e semaforëve (2020-2023);
14. Trajtimi i mbeturinave ndërtimore;
15. Vendosja e kamerave për trafik;
16. Ndërtimi i strehimores për qentë endacakë;
17. Miratimi i 4 rregulloreve: Rregullorja për organizimin e transportit rrugor, Rregullorja për obligimet e pronarëve dhe bashkëpronarëve të pronës në komunën e Prishtinës, Rregullorja për mbrojtjen e mjedisit;
18. Ngritja e aftësive profesionale të zyrtarëve për specifikime teknike, për projekte të planifikuara nga DSHPMSH, në bashkëpunim me konsulentë të angazhuar nga USAID;
19. Regjistrimi i objekteve të vjetruara dhe zonave me rrezikshmëri të lartë;
20. Përpunimi i planeve emergjente POE, PMZ, PRRFN;
21. Mirëmbajtja e strehimoreve dhe përgatitja e specifikave teknike dhe paramasave;
22. Hartimi i Planit të veprimit për përmbushjen e kërkesave të paraqitura nga auditori i brendshëm;
23. Mbledhja e të dhënave dhe punimi i raportit dhe raportimi në AMMK për vitin 2019;
24. Pranimi dhe punimi i lëndëve nga Komisioni i ankesave për mbeturina dhe ekzekutimi i vendimeve në databazë;
25. Rishikimi dhe inkorporimi i ndryshimeve të nevojshme në databazë për konsumatorët e shërbimit për grumbullim të mbeturinave;
26. Krijimi i sistemit për monitorimin e aktiviteteve financiare të DSHPMSH-së;
27. Pranimi i ankesave nga Platforma digjitale dhe Ndreqe.com, dhe adresimi i tyre;
28. Rregullimi i trafikut në rrethrotullime, ndarja fizike e shiritit rrugor në rreth rrotullime dhe vendosja e tabelave informuese në portale dhe gjysmë portale;
29. Përgatitja e projektbuxhetit të DSHPMSH-së për 2021;

30. Përgatitja e Planit të prokurimit të DSHPMSH-së 2021;

31. Rishikimi 3-mujor i Planit të punës.

Realizimi i Buxhetit – planifikimi i buxhetit për vitin 2019 (të paraqitet me përqindje %)

• Buxheti i përgjithshëm për drejtorinë e DSHPMSH	3,890,000.00 €;
• Buxhet i realizuar	966,503.57 €;
• Mbetja me kontrata në realizim	1,985,946.79 €;
• Të hyrat nga DSHPMSH-ja janë	2,857,962.24 €.

- **Përmbledhje** – Progresi i drejtorisë drejt realizimit të objektivave të vendosura për vitin 2019 (këtu mund të përfshihen edhe monitorimet nga organizatat joqeveritare).

- Paragraf 10-12, rreshtat ku përfshihet vlerësimi për objektivat e drejtorisë. Gjithashtu sugjerimet apo edhe vërejtjet e organizatave monitoruese, si mund të implementohen ato për funksionim sa më të mirë të drejtorisë përkatëse.

Në bazë të Planit të veprimit të DSHPMSH-së për vitin 2019, janë përcaktuar 12 objektiva, në bazë të cilave janë planifikuar aktivitetet, me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve të drejtorisë ndaj qytetarëve. Nga objektivat e planifikuara janë realizuar apo janë në realizim rreth 70% të tyre.

Realizimi i këtyre objektivave ka ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve, si në fushën e transportit publik, lirim të hapësirave publike në veçanti të trotuareve për lëvizje të lirë të qytetarëve. Me mirëmbajtje të rregullt të rrugëve dhe trotuareve në zonat urbane dhe rurale, është ofruar siguri për pjesëmarrësit në trafik dhe pastërti, e cila ndikon edhe në cilësinë e ajrit. Po ashtu menaxhimi i mbeturinave ka rritur cilësinë e një mjedisi më të pastër, ngase janë larguar deponi të shumta të mbeturinave, është rregulluar sistemi i grumbullimit të mbeturinave me riorganizim e planit të operimit.

Me zgjerimin e nyjave të reja semaforike dhe të ndriçimit publik, është rritur siguria e përgjithshme për qytetarë dhe siguria në trafik, gjatë lëvizjes në hapësira publike, përfshirë këtu rrugët, shtigjet për këmbësorë, platotë, parkingjet dhe parqet.

Nga kjo shihet se synimi i DSHPMSH-së është arritja dhe realizimi i të gjitha objektivave, të cilat ndikojnë në përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve që ndikojnë në rritjen e kushteve të jetës së qytetarëve, në ambient të pastër dhe të sigurt me standarde urbane.

Vlen të përmenden edhe vlerësimet pozitive mbi punën e DSHPMSH-së, të bëra nga organizatat jashtë Komunes, për shembull INPO, e cila ka hulumtuar kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet e ofruara nga Komuna. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë për një rritje të konsiderueshme të kënaqshmërisë së qytetarëve nga viti 2018 në vitin 2019, me disa shërbime që mbuloohen, siç janë:

Krahasimi 2018-2019, ku kemi ngritje në këto shërbime:

- Ndriçimi publik nga 59.09% në 66.09%;
- Mirëmbajtja e parqeve, shesheve dhe hapësirave publike, nga 46.56% në 49.27%;
- Shërbimet e transportit publik, nga 66.83% në 81.08%;
- Oraret e qarkullimit të transportit publik, nga 58.11% në 77.15%;
- Grumbullimi i mbeturinave, nga 53.68% në 67.82%.